


Gjuha e lehtë

Të drejtat e edukimit për personat me aftësi të kufizuar

Udhëzime



Falenderojmë anëtarët e shoqatës
Klubi Dëshira

Grupi Kontrollues:

Lumnije Demolli

Qëndrim Jashari

Driton Krasniqi

Hasan Krasniqi



© European Easy-to-Read Logo: Inclusion Europe.

Më shumë informata në:

www.inclusion-europe.eu/easy-to-read

Gjuha e lehtë do të thotë që teksti është i kuptueshëm dhe i arritshëm për të gjithë, pavarësisht nga aftësia intelektuale apo pengesa të tjera për të kuptuar.

Shënim: Përmbajta e kësaj broshure është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe nuk pasqyron detyrimisht pikëpamjet e Renovabis dhe Caritas Austria.

Hyrje



Kjo broshurë ju ndihmon të kuptoni më mirë të drejtën tuaj për edukim.



Broshura përmban të gjitha ligjet që ju garantojnë shkollimin.


Konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara



Konventa e nënshkruar më 2007 nga shtetet e Organizatës të Kombeve të Bashkuara detyron shtetet në botë të respektojnë barazin e gjithë njerëzve.



Kjo konventë na thotë që personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të shkollohen dhe mësojnë gjatë gjithë jetës.



Sipas kësaj konvente ju duhet të trajtoheni njësoj me të gjithë nxënësit tjerë.

Ju nuk duhet të ndaheni fizikisht nga nxënësit tjerë.



Ju keni të drejtë të tregoni dhe të praktikoni talentin tuaj në shkolla.



Sipas konventës shteti duhet të ju sigurojë një të ardhme të mirë kur të përfundoni shkollimin.

KUSHTETUTA E KOSOVËS




Kushtetuta është një libër në të cilin shkruhen të gjitha ligjet e një shteti.

Çdo institucion dhe të gjithë qytetarët e Kosovës obligohen të respektojnë këtë libër.




Kushtetuta jonë në Ligjin e 47-të thotë që çdo person duhet të shkollohet pa pagesë në shkollat publike.



Kushtetuta thotë që shteti duhet të kujdeset për edukimin tuaj, të jeni të barabartë me të gjithë personat e tjerë.

Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës



Ligji 46-të na tregon si duhet t'i mbrojmë nxënësit me aftësi të kufizuara:

- Ju keni të drejtat e njëjta me të gjithë të tjerët



- Shteti duhet të ju ofrojë mbështetje që të krijoni vetëbesim dhe të jeni pjesë e shoqërisë.

- Shteti duhet të ju ndihmojnë financiarisht që të shkolloheni.



Ligji për mbrojtjen e fëmijës


Këtë ligj duhet ta përmbush Ministria për Mirëqenje Sociale dhe Ministria e Arsimit.

Ky ligj ju thotë këtyre dy ministrive që:



- Fëmijët me aftësi të kufizuara të mbrohen nga diskriminimi, dhuna fizike e mendore, abuzimi dhe keqtrajtimi.

- Të respektojnë dhe zhvillojnë aftësitë e fëmijëve me aftësi të kufizuar.



- Të ofrojnë pajisje dhe programe për t'i pavarësuar fëmijët me aftësi të kufizuar.

- Të ofrojnë mundësi komunikimi për fëmijë me aftësi të kufizuar.

- Të gjitha shkollat të ofrojnë qasje të lehtë për të gjithë nxënësit me aftësi të kufizuar.



· Informatat duhet të jenë të thjeshta dhe të kuptueshme për personat me aftësi të kufizuara.

Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës



Ky ligj i Kosovës bazohet në konventën e Kombeve të Bashkuara.



Ligji thotë që shteti duhet të ju ofroj ndihmë komunave për të ndërtuar shkolla të përshtatshme për nxënësit me aftësi të kufizuar.




Ky ligj thotë që shteti të ndihmoj komunën me tekste shkollore të përshtatshme për nxënësit me aftësi të kufizuar.

Transport falas dhe të sigurt



Komunat sigurojnë transport shkollor falas, të sigurtë, dhe të përshtatshëm për fëmijët me aftësi të kufizuar.

Në rast se nuk i gëzoni këto të drejta atëherë mund të ankoheni.



Ankesën mund ta bëni tek institucioni i Avokatit të popullit:



Telefoni: 038223782

Email: info.oik@oik-rks.org

Adresa: Rruga Migjeni, 10000
Prishtinë.



Për të përmirësuar punën, ju lutemi vlerësoni tekstin.
Këtë mund ta bëni duke skanuar kodin QR ose
nëpërmjet lidhjes:

<https://forms.gle/CXiTFVyn91Vxd4wJ8>



**CARITAS
KOSOVA**

Përgatitur: Caritas Kosova

www.caritaskosova.org / 383 (0) 290 328 110

info@caritaskosova.org

**Adresa: Rr. Shën Nënë Tereza Nr. 3/Kisha Katolike
70000 Ferizaj, Kosovë**